

FLETËUDHËZUES: INFORMACION PËR PACIENTIN

BRONCHOSTOP sine Hustensaft (shurup për kollë)

Lëndë aktive: ekstrakt i thatë i trumzës, ekstrakt i lëngshëm i rrënjës së mëllagës së bardhë

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të nisni përdorimin e këtij bari sepse përmban informacion të rëndësishëm për ju.

Gjithmonë merrni këtë bar saktësisht siç përshkruhet në këtë fletëudhëzues ose siç ju ka thënë mjeku ose farmacisti juaj.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Pyesni farmacistin tuaj nëse keni nevojë për më shumë informacion ose këshilla.
- Nëse keni ndonjë efekt anësor, bisedoni me mjekun ose farmacistin tuaj. Kjo përfshin çdo efekt anësor të mundshëm që nuk është i shënuar në këtë fletëudhëzues. Shihni seksionin 4.
- Duhet të flisni me mjekun nëse nuk ndiheni më mirë ose nëse ndiheni më keq pas 5 ditësh

Çfarë përmban ky fletëudhëzues:

1. Çfarë është *BRONCHOSTOP sine Hustensaft* dhe për çfarë përdoret
2. Çfarë duhet të dini përpara se të përdorni *BRONCHOSTOP sine Hustensaft*
3. Si merret *BRONCHOSTOP sine Hustensaft*
4. Efekte të mundshme anësore
5. Si ruhet *BRONCHOSTOP sine Hustensaft*
6. Përbërësit e paketimit dhe të dhëna të tjera

1. Çfarë është *BRONCHOSTOP sine Hustensaft* dhe për çfarë përdoret

Bar bimor tradicional për të lehtësuar iritimin e fytit dhe për të promovuar ekspektorimin e mukusit të trashë në kollën e shoqëruar me ftohje.

Ky produkt është një bar bimor tradicional i regjistruar për t'u përdorur në indikacionet e specifikuar, bazuar vetëm në përdorimin e gjatë.

Ky bar indikohet për të rriturit, adoleshentët dhe fëmijët nga mosha 2 vjeç.

Duhet të flisni me një mjek nëse nuk ndiheni më mirë ose nëse ndjeheni më keq pas 5 ditësh.

2. Çfarë duhet të dini përpara se të përdorni *BRONCHOSTOP sine Hustensaft*

Mos përdorni *BRONCHOSTOP sine Hustensaft*

- nëse jeni alergjik (hipersensitiv) ndaj bimës së trumzës, rrënjës së mëllagës së bardhë, ndaj anëtarëve të tjerë të familjes Lamiaceae ose ndonjë prej përbërësve të tjerë të këtij bari të listuar në seksionin 6.

Përkujdesje dhe paralajmërime

Kontaktoni me mjekun ose farmacistin përpara se të përdorni BRONCHOSTOP sine Hustensaft, - nëse keni astmë. Shurupi i kollës BRONCHOSTOP sine Hustensaft mund të përkeqësojë simptomat e astmës.

- Nëse jeni të prirur për të zhvilluar reaksione alergjike.

Ky bar mund të shkaktojë reaksione alergjike, të cilat në raste shumë të rralla mund të jenë serioze (anafilaksia, shoku anafilaktik).

Në rast temperature, vështirësi në frymëmarrje ose sekrecione purulente, duhet të këshilloheni me mjekun.

Fëmijët

Përdorimi te fëmijët nën 2 vjeç nuk rekomandohet për shkak të mungesës së të dhënave dhe për shkak se duhet kërkuar këshilla mjekësore. Për kollën tek fëmijët nën moshën 2 vjeç duhet të konsultoheni me një mjek për të përjashtuar një sëmundje serioze.

Barna të tjerë dhe BRONCHOSTOP sine Hustensaft

Informoni mjekun ose farmacistin nëse jeni duke marrë / përdorur, keni marrë kohët e fundit / përdorur, ose keni ndërmend të merrni / përdorni barna të tjera.

Mund të vonojë marrjen e barnave kur administrohen njëkohësisht. Si masë paraprake, produkti nuk duhet të merret ½ deri në 1 orë para ose pas marrjes së barnave të tjera.

Asnjë studim i ndërveprimit nuk është kryer. Deri më tani nuk dihen ndërveprime.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gji

Nëse jeni shtatzënë apo gjatë ushqyerjes me gji, dyshoni se mund të jeni shtatzënë ose jeni duke planifikuar për të mbetur shtatzënë, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj për këshilla para se të merrni këtë bar.

Në mungesë të të dhënave të mjaftueshme, përdorimi gjatë shtatzënisë dhe ushqyerjes me gji nuk rekomandohet.

Drejtimi i automjeteve dhe përdorimi i makinerive

Asnjë studim mbi efektet në aftësinë për të drejtuar dhe për të përdorur makineri nuk janë kryer.

BRONCHOSTOP sine Hustensaft përmban koncentrat të lëngut të mjedrës e cila përmban sakarozë, glukozë dhe fruktozë.

Ky bar përmban 66 mg fruktozë në 15 ml BRONCHOSTOP sine Hustensaft.

Nëse mjeku juaj ju ka thënë që ju (ose fëmija juaj) keni një intolerancë ndaj disa sheqernave ose nëse jeni diagnostikuar me intolerancë të trashëguar të fruktozës (HFI), një çrregullim gjenetik i rrallë në të cilin një person nuk mund të tresë fruktozën, bisedoni me mjekun tuaj para se ju (ose fëmija juaj) të merrni këtë bar.

BRONCHOSTOP sine Hustensaft përmban propilen glikol.

Ky bar përmban 38.9 mg propilen glikol në 15 ml.

BRONCHOSTOP sine Hustensaft përmban metil-4-hidroksibenzoat dhe propil-4-hidroksibenzoat si konservues. Këto mund të shkaktojnë reaksione alergjike të cilat gjithashtu mund të shfaqen si një reagim i vonuar (shiko "Mos e merrni BRONCHOSTOP sine Hustensaft").

BRONCHOSTOP sine Hustensaft përmban natrium.

Ky bar përmban më pak se 1 mmol natriumi (23 mg) për dozë 15 ml, që do të thotë në thelb "pa natrium".

3.Si të merrni *BRONCHOSTOP sine Hustensaft*

Gjithmonë merrni këtë bar pikërisht siç përshkruhet në këtë fletëudhëzues ose si jua ka përshkruar mjeku ose farmacisti juaj . Kontrolloni me mjekun ose farmacistin tuaj nëse ju nuk jeni të sigurt.

Doza e rekomanduar është:

Të rriturit dhe adoleshentët mbi 12 vjeç:

15 ml çdo 3 deri në 4 orë (4 deri 6 herë në ditë; doza maksimale ditore deri në 90 ml).

Fëmijët nga 4 - 11 vjeç:

7.5 ml çdo 3 deri në 4 orë (4 deri 6 herë në ditë; doza maksimale ditore deri në 45 ml).

Fëmijët nga 2 - 3 vjeç:

Pas konsultimit me një mjek, 7.5 ml çdo 3 deri në 4 orë (4 deri 6 herë në ditë; doza maksimale ditore deri në 45 ml) mund të administrohet.

Fëmijët më të vegjël se 2 vjeç:

Përdorimi te fëmijët nën 2 vjeç nuk rekomandohet për shkak të mungesës së të dhënave dhe për shkak se duhen kërkuar këshilla mjekësore.

Metoda e administrimit:

Për përdorim oral.

Merrni *BRONCHOSTOP sine Hustensaft* të pa holluar, duke vendosur dozën e lartpërmendur në tapën matëse e cila ka një shkallëzim prej 2,5 ml deri në 20 ml.

Në qoftë se keni nevojë , ju mund të merrni *BRONCHOSTOP sine Hustensaft* të holluar në ujë ose çaj të ngrohtë.

Kohëzgjatja e administrimit:

Ju duhet të flisni me mjekun tuaj nëse nuk ndiheni më mirë ose nëse ndjeheni më keq pas 5 ditësh.

Nëse keni marrë më tepër *BRONCHOSTOP sine Hustensaft* se sa ju duhet

Nuk është raportuar asnjë rast mbidozimi.

Nëse harroni të merrni *BRONCHOSTOP sine Hustensaft*

Mos merrni një dozë të dyfishtë për të kompensuar dozën e harruar.

Nëse keni ndonjë pyetje tjetër mbi përdorimin e këtij bari, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. Efektet anësore të mundshme

Si të gjitha barnat e tjerë, ky bar mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo të gjithë i shfaqin ato.

Frekuenca e shfaqjes së efekteve anësore të mëposhtme nuk dihet (frekuenca nuk mund të vlerësohet nga të dhënat e disponueshme).

Ky bar mund të shkaktojë reaksionet e rënda alergjike të mëposhtme. Nëse përjetoni ndonjë nga efektet e mëposhtme, ndaloni marrjen e barit dhe kërkoni këshilla urgjente mjekësore:

- simptoma që mund të përfshijnë ndjesinë e kokës së lehtë ose të fikëti, vështirësi në frymëmarrje ose fishkëllimë, rrahje të shpejta të zemrës, skuqje të lëkurës, konfuzion dhe ankth, ose humbje të vetëdijes (reaksion anafilaktik)
- ënjtje e fytyrës, buzëve, gjuhës, gojës ose fytyrës (angioedemë),
- fluska në gojë dhe në fyt
- vështirësi në frymëmarrje (përfshirë gulçim)

Efekte të tjera të mundshme anësore

Nëse ndonjë nga efektet anësore të mëposhtme bëhet serioz ose ju shqetëson, ose vëreni ndonjë efekt tjetër anësor, ndaloni marrjen e barit dhe kërkoni këshilla mjekësore sa më shpejt të jetë e mundur:

- Reaksione alergjike të lëkurës duke përfshirë urtikarien (fluska të kuqe në lëkurë) dhe kruajtje.
- Çrregullime gastrointestinale si dhimbje ose parehati në bark, diarre, të vjella dhe të përziera.

Raportimi i efekteve anësore

Nëse vëreni ndonjë efekt anësor, bisedoni me mjekun tuaj ose farmacistin. Kjo vlen edhe për efektet anësore të cilat nuk janë shënuar në fletëudhëzues.

Ju gjithashtu mund të raportoni efektet anësore direkt nëpërmjet sistemit kombëtar të raportimit:

Bundesamt für Sicherheit im Gesundheitswesen

Traisengasse 5

1200 VIENNA

AUSTRIA

Fax: + 43 (0) 50 555 36207

Website: <http://www.basg.gv.at/>

Nga raportimi i efekteve anësore, mund të kontribuoni duke siguruar më shumë informacion mbi sigurinë e këtij bari.

5. Si të ruhet *BRONCHOSTOP sine Hustensaft*

Mos e ruani mbi 25°C.

Shishja ruhet në paketimin origjinal, në mënyrë që përmbajtja të mbrohet nga drita. Mbylleni mirë shishen pas përdorimit.

Mbajeni këtë bar në vende që nuk shihen dhe nuk arrihen nga fëmijët.

Mos e përdorni këtë bar pas datës së skadencës ("Përdoret deri:") e shënuar në kutinë e jashtme të kartonit. Data e skadimit i referohet ditës së fundit të muajit të shënuar.

Pas hapjes së shishes, përdorni përmbajtjen brenda 4 javësh.

Mos i hidhni barnat nëpërmjet ujërave të zeza apo mbeturinave shtëpiake. Pyesni farmacistin si duhet të hidhni barnat në qoftë se ju nuk i përdorni më ato. Kështu mund të kontribuoni në mbrojtjen e mjedisit.

6. Përmbajtja e paketimit dhe informacione shtesë

Çfarë përmban *BRONCHOSTOP sine Hustensaft*

Lëndë aktive janë :

15 ml (= 15.45 g) përmbajnë:

0.12 g ekstrakt i thatë i trumzës (Thymi herba, raporti bar- ekstrakt = 7-13: 1 (DER), agjent ekstraktimi: ujë)

0.83 g ekstrakt i lëngshëm i rrënjës së mëllagës së bardhë (Althaeae radix, raporti bar- ekstrakt = 1:13 (DER), agjent ekstraktimi: ujë)

Përbërësit e tjerë janë:

Maltodekstrin, akacie, ksilitol (E 967), metil-4-hidroksibenzoat (E 218), koncentrat i lëngut të mjedrës (që përmban sakarozë, glukozë dhe fruktozë), gomë xantan, acidit citrik monohidrat (E 330), propil-parahidroksibenzoat (E 216), aromë mjedre (që përmban propilen glikol (E 1520)), glicerinë (E 422), sakarinat natriumi (E 594), dihidrokalkonat-neohesperidine, ujë i purifikuar

Si duket *BRONCHOSTOP sine Hustensaft* dhe përmbajtja e paketimit

BRONCHOSTOP sine Hustensaft është një tretësirë me ngjyrë të kuqe kafe, viskoze për përdorim nga goja me aromën dhe shijen e trumzës dhe mjedrës. Mbushet në shishe qelqi ngjyrë kafe me kapak të mbyllur me vidhosje, në madhësi 100 ml, 120 ml, 150 ml dhe 200 ml. Jo të gjitha madhësitë e paketimeve do të tregtohen domosdoshmërisht.

Kupa matëse me një shkallëzim midis 2.5 ml dhe 20 ml lehtëson matjen e saktë të dozës së rekomanduar.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi

KWIZDA Pharma GmbH, A-1160 Vienna

www.bronchostop.at

Reg. no.: HERB-00085

Ky fletëudhëzues është rishikuar për herë të fundit në Qershor 2023.